



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË ASESTEVE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 769 Prot.
2

Koplik, më 30.01.2026

PROJEKT -VENDIM
Nr _____, Datë ____ / ____ / 2026

PËR
PROPOZIMIN PËR DHURIMIN ME KUSHT TË NJË AUTOMJETI ZJARRËFIKËS
AUTOSHKALLË NË FAVOR TË BASHKISË TIRANË

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”.

VENDOSI:

Që ti propozojë Këshillit të Bashkisë Malësi Madhe :

1. Miratimin e dhurimit me kusht të një automjeti zjarrëfikës në pronësi të Bashkisë Malësi e Madhe në favor Bashkisë Tiranë.
2. Dhurimi realizohet me kushtin e detyrueshem që Bashkia Tiranë ti dhurojë Bashkisë Malësi e Madhe, në shkëmbim një automjet zjarrëfikës urban, në gjendje funksionale, të përshtatshëm për nevojat operacionale të territorit të Bashkisë Malësi e Madhe.
3. Pranimin e dhurimit të një automjeti zjarrëfikës nga Bashkia Tiranë, në favor të Bashkisë Malësi e Madhe.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe Kryetari i Bashkisë Malësisë së Madhe.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETAR
TONIN MARINAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË ASESTEVE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 269/1 Prot.

Koplik, më 30.01.2026

RELACION
PËR

MBI PROPOZIMIN PËR DHURIMIN ME KUSHT TË NJË AUTOMJETI
ZJARRËFIKËS AUTOSHKALLË BASHKISË TIRANË

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” propozon:

Të nderuar këshilltarë

Bashkia Malësi e Madhe, siç edhe është vërejtur në sezonet e kaluara, ka hasur shpesh vështirësi në menaxhimin dhe përballimin e situatave të shkaktuara nga zjarret në territorin tonë. Kjo edhe për shkak të territrit të gjerë por edhe për shkak të pamjaftueshmërisë së mjeteve të përshtatshme për këto situata.

Pranë sektorit të MZSH, Bashkia Malësi e Madhe disponon një automjet zjarrëfikëse të tipit Autoshkallë PERD IVECO MAGIRUS VP 1998 me nr. Shasie ZCFA1LLH002198460, me targa INXB382 ,i cili nuk përdoret nga shërbimi mbrojtjes ndaj zjarrit (kjo për shkak të tipologjisë së shërbimeve që kryhen me anë të tij) dhe nuk përbën prioritet për territorin e Bashkisë,për shkak të tipologjisë së ndërtesave dhe natyrës së ndërhyrjeve në territorin e bashkisë.

Bazuar në kërkesen nr.3240 prot datë 22.01.2026 të Bashkisë Tiranë, pas komunikimeve nepermjet sektorëve të MZSH, propozohet që ky mjet t'i dhurohet Bashkisë Tiranë me kushtin që Bashkia Tiranë t'i dhurojë Bashkisë Malësi e Madhe një automjet zjarrëfikës urban, të përshtatshëm për nevojat operacionale të territorit tonë.

Nga ana tjetër,ky mjet është më i përshtatshëm për Bashkinë Tiranë për shkak të numrit të madh të objekteve shumëkateshe. Qëllimi i ndërrimit është përmirësimi eficiencës së shërbimit zjarrfikës,rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, uljen e shpenzimeve afatgjata si dhe pajisja e Sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi të Bashkisë Malësi e Madhe, me një automjet zjarrfikës urbane,të përshtatshme për ndërhyrjet në situata emergjencash civile.

Ndërkohë,Bashkia Malësi e Madhe ka nevojë konkrete për një automjet zjarrfikës urban i cili do të përmirësonte ndjeshëm kapacitet e ndërhyrjes në situata emergjente.

Për këto arsye,dhurimi me kusht vlerësohet në interesin publik, realizohet pa kosto financiare dhe synon përmirësimin e kapaciteteve operacionale të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi në të dy njësive e vetqeverisjes vendore.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

